- (g) Kontraktuesi has në pengesa për kryerjen e aktiviteteve të punëve të kontraktuara të cilat pengesa nuk janë për shkak të joprofesionalizmit të Kontraktuesit.

30.2 Nëse një ngjarje e tillë ndodh, atëherë Çmimi i Kontratës do të rregullohet po ashtu.

PRANIMI DHE PËRGJEGJËSIA MBI DEFEKTET

Neni 31 Parimet e përgjithshme

31.1 Verifikimi i punëve nga Autoriteti Kontraktues me qëllim të pranimit të përkohshëm ose final do të bëhet në prani të Kontraktuesit. Mungesa e kontraktuesit nuk do të jetë pengesë për verifikimin me kusht që Kontraktuesi të jete informuar prej të paktën 30 ditëve para datës së verifikimit.

Neni 32 Testet për përfundimin

32.1 Punët nuk do të pranohen deri sa të jene kryer verifikimet dhe testet e caktuara ne shpenzime të Kontraktuesit. Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktues për datën në të cilën verifikimi dhe testet të tilla mund të fillojnë.

32.2 Punët të cilat nuk plotësojnë kushtet e kontratës, duhet, nëse kërkohet, të shkatërrohen dhe rindërtohen nga kontraktuesi ose të riparohen, sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues, përndryshe kjo do të bëhet pas njoftimit të duhur në shpenzime të Kontraktuesit, me urdhër të Autoritetit Kontraktues.

Neni 33 Pranimi i përkohshëm

33.1 Punimet do të merren përsipër nga Autoriteti kontraktues kur të kenë kaluar në mënyrë të kënaqshme testet për pranim dhe të jete lëshuar, ose konsiderohet të jete lëshuar, një certifikatë e pranimit të përkohshëm.

33.2 Kontraktuesi mund të aplikojë, duke njoftuar Autoritetin Kontraktues, për një certifikatë të pranimit të përkohshëm jo më herët se 15 ditë para se punët, sipas mendimit të Kontraktuesit, të jene të gatshme për pranim të përkohshëm. Autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh pas pranimit të aplikacionit të Kontraktuesit ose:

- a) t'i lëshojë kontraktuesit certifikatën e pranimit të përkohshëm me një kopje për Autoritetin kontraktues duke thënë, nëse kjo është e përshtatshme, rezervat e tij, dhe përveç tjerash, edhe datën në të cilën sipas mendimit të tij janë përfunduar punët në pajtim me kontratën dhe janë të gatshme për pranim të përkohshëm; ose
- b) të refuzojë aplikacionin, duke i dhënë arsyet e tij dhe duke specifikuar veprimin të cilin, sipas mendimit të tij i kërkon nga Kontraktuesi për ta lëshuar certifikatën.

33.3 Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin ose të lëshojë certifikatën e pranimit të përkohshëm ose të refuzojë furnizimet brenda një periudhe prej 30 ditësh, ai do të konsiderohet se ka lëshuar certifikatën në ditën e fundit të asaj periudhe.

33.4 Pas pranimit të përkohshëm të punëve, Kontraktuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkohen më për përdorim përkitazi me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe do të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimit siç kërkohen në kontratë.

Neni 34

Përgjegjësia mbi Defektet

34.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve, në ndonjë pjesë të punëve të cilat mund të shfaqen apo shfaqen gjatë periudhës së defekteve dhe të cilat lindin nga ose:

- a) përdorimin i impiantit ose materialeve të dëmtuara ose mjeshtëria ose dizajni i gabueshme i Kontraktuesit; dhe / ose
- b) çdo veprim apo mosveprim i Kontraktuesit gjatë periudhës së defekteve.

34.2 Kontraktuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt të jetë e mundur. Periudha mbi përgjegjësinë e defekteve për të gjitha zëvendësimet ose rinovimet do të fillojë nga data kur zëvendësimi ose rinovimi është bërë për kënaqësinë e mbikëqyrësit. Nëse kontrata mundëson pranim të pjesshëm, periudha e defekteve do të vazhdojë vetëm për atë pjesë të punimeve e cila është ndikuar nga ndërrimi apo rinovim.

34.3 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së përmendur, autoriteti kontraktues ose menaxheri i projektit do ta njoftojnë Kontraktuesin. Nëse Kontraktuesi nuk arrin të korrigjojë një defekt ose një dëm brenda afatit kohor të përcaktuar në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të kryejë vetë punë, ose të punësojë dikë tjetër për kryerjen e punimeve, në rrezik dhe kosto të Kontraktuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga pagesat e pritura ose nga garancitë që mbahen ndaj Kontraktuesit ose nga të dy; ose
- b) të ndërpresë kontratën.

34.4 Në rastet urgjente, kur kontraktuesi nuk mund të arrihet menjëherë ose, pasi është arritur, nuk është në gjendje që të marrë masat e nevojshme, autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit mund të kryejnë punën në kurriz të Kontraktuesit. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit duhet të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur Kontraktuesin për veprimin e marrë.

34.5 Periudha e përgjegjësisë së defekteve do të parashihet në KVK dhe specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së përgjegjësisë së defekteve nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e Përgjegjësisë së defekteve do të fillojë në datën e pranim të përkohshëm.

Neni 35

Pranimi përfundimtar

35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Kontraktuesit një certifikatë të pranimi përfundimtar, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimi do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 34 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimi nga Menaxheri i Projektit dhe të jetë dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimi dhe të cilat kanë mbetur të parealizuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimi. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

SHKELJA E KONTRATËS DHE SHKËPUTJA

Neni 36

Shkelja e kontratës

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumatat që duhet t'i paguhet Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria

Neni 37 Shkëputja e kontratës

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijnë, por nuk do të kufizohet në:

- a. Kontraktuesi ndërpre punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonës;
- c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
- d. Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- f. Kontraktuesi vonohet në përmbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesi do të përfundojë vazhdimësinë e përmbushjes së punëve sa më parë që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të sigurojë vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

Neni 38 Forca madhore

38.1 "Force Madhore" siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplodimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkaktuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcaktojnë Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësi të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcaktojnë Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

Neni 39**Pagesa pas shkëputjes së kontratës**

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri Projektues do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshojë një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riadhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

Neni 40**Prona**

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 41**Lirimi nga Ekzekutimi**

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të vërtetojë këtë. Kontraktuesi do të sigurojë vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE**Neni 42****Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve**

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 43**Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore**

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 632-25-733-5-2-1/C1058

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha shqipe.
Siguria e ekzekutimit	10.1	Kontraktuesi obligohet që para nënshkrimit të kontratës të bëjë depozitim të sigurisë së ekzekutimit 10% i vlerës së kontratës me vlefshmëri prej 3 muaj.
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim lidhur me punët, ndonjë pjesë të tyre, materialet apo impiantin gjatë periudhës mbi të cilën kontraktuesi është përgjegjës për përkujdesjen e tyre, për çfarëdo arsye, përpos rreziqeve të definuara sipas nenit 38 të KPK, kontraktuesi korrigjon humbjen apo dëmtimin e tillë nën shpenzimet e veta, në mënyrë që punët e përhershme në çdo aspekt të jenë në përputhje me dispozitat e kontratës sipas kërkesave të menaxherit të kontratës. Kontraktuesi siguron punët, së bashku me materialin dhe impiantin gjër në koston e zëvendësimit të plotë; (b) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre; (c) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është 15.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar. (d) Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje: (i) e punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar e personave të tjerë: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzojë për aprovim Programin për Punët brenda 5 ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periudha për Programin e azhurnuar është 5 ditë
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë menjëherë pas pranimit të kërkesës së Menaxherit të projektit për fillim të punimeve
	17.2	Data e përfundimit të të gjitha Punëve do të jetë 2 muaj.
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë 0.25% e Çmimit përfundimtar të Kontratës për ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10% e Çmimit final të Kontratës.

Regjistri i punës	20.1	Një regjistër i punës do të mbahen në vend-punishte nga ana e Kontraktuesit.
Inspektimi dhe testimi	22.1	Ekipi për menaxhimin e kontratësdo të caktohet me vendim të ZKA.
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: nuk ka pagese paraprake
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: nuk është e nevojshme
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë 5 ditë para fillimit të punimeve.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Perioda garantuese e defekteve është 90 ditë.
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve të likuiduara.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik – Divizioni i rregullave
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatën Themelore-Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë.

DRAFT - PARAMASA DHE PARALLOGARIA**HARTIMI I PROJEKTIT TË PARKUT " XHUBLETA"****LOKACIONI: GJAKOVË****INVESTITORI: KUVENDI KOMUNAL GJAKOVË****VËREJTJE:**

Materialet e propozuara në përshkrim teknik dhe paramasë janë opcionale dhe pikë referimi për karakteristikat e materialeve që duhet të përdoren andaj të gjitha ato mund të zëvendësohen me materiale të prodhuesve tjerë me karakteristika të njëjta ose më të mira që duhet dëshmuar me certifikatat apo atestet e ofruara nga prodhuesit respektiv. Në të gjitha pozicionet përfshihet FURNIZIMI DHE MONTIMI/PUNIMI I ATIJ POZICIONI. TEK PASTRIMET, DEMOLIMET E GERMIMET TË PËRFSHIHET EDHE TRANSPORTI DERI NË DEPONI.

1 PUNËT NDËRTIMORE				
1.01 PUNËT PARAPREGADITORE DHE DEMOLIMEVE				
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJESIA	SASIA	CMIMI/NJESI SHUMA
1.01.01	Mobilizimi i ndërmarrjes për fillimin e punimeve si në projekt. Sjellja e makinerive të nevojshme për fillim të punimeve.	cope	1	250.00 € 250.00 €
1.01.02	Furnizimi me material për vedosjen e tabelës me emrat e investitorit, ndërmarrjes projektuese dhe ndërmarrjes ndërtuese, vlerës investuese dhe fillimin dhe mbarimin e projektit. Tabela duhet të punohet nga materialet e kualitetit të lartë- shtypje me ngjyra në cerade dhe me shtyp të kualitetit të mirë për dukje të qartë nga distanca e largët. Dimensionet minimale të tabelës duhet të jenë: Gjatësia 2.5m, Gjerësia 1.5m, si dhe lartësia totale së bashku me kembizat 2.5-3.0m. Të gjitha duhet të punohen me udhëzime nga mbikqyresit e punimeve.	cope	1	250.00 € 250.00 €
1.01.03	Të parashihet zyra e përkohshme e ndërmarrjes më së paku 2 ndarje, secila ndarje duhet të ketë së paku sipërfaqe S=12m ² , me nyle sanitare si dhe e kyçur në furnizimin me energji të pandërprerë elektrike dhe të ujit. Zyra duhet të ketë lidhje në kanalizimin publik funksional ose në një rezervuar ekologjik mobil	cope	1	500.00 € 500.00 €
1.01.04	Të bëhet pastrimi i terrenit prej materialeve të cilat konsiderohen pengesa për zhvillimin e punimeve, si: heqja e shkurreve, pjesëve të betonit/ thyerja e tyre dhe mbeturinave/materialeve të tjera që ndodhen në sipërfaqe të terrenit të parkut. Njëherë material i grumbulluar parashihet të dërgohet/transportohet deri në deponi, sipas Menagjerit të kontratës, (largësia në rreze deri në 5km).	m ²	1,420	1.00 € 1,420.00 €
1.01.05	Shënjestimi i instalimeve nëntoksore të cilat nuk çvendosen nga pozicioni ekzistues. Të bëhet edhe shënjestimi i lokacionit para fillimit të punimeve ku parashihet lokacioni për punimin e parkut xhubleta.	cope	1	300.00 € 300.00 €
1.01.06	Rrethimi i komplet punishtes në perimetër të saj në mënyrë që mos të ketë qasje nga kalimtarët e rastit. Rrethimi të bëhet nga materiali i përkatës për këtë lloj pune d.m.th nga materialet të përkatës dhe i cili lejon zhvillim normal të punimeve në gjithë orarin sipas kërkesave të investitorit.	m'	170	3.00 € 510.00 €
1.01.07	Pozicionimi gjeodezik i parcelles në të cilën do të punohet parku si dhe shënjestimi i elementeve të parkut.	komplet	1	300.00 € 300.00 €
TOTAL POZICIONI			1.01	3,530.00 €
1.02 PUNËT E GERMIMIT, DHEUT DHE TË ZHAVORIT				
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJESIA	SASIA	CMIMI/NJESI SHUMA
1.02.01	Gërmimi i shtresës së humusit dhe dheut me trashësi deri 15 cm tërë sipërfaqen e parapardë për punimin e parkut. Në çmim duhet të përfshihet edhe transportimi i dheut të gërmuar deri në deponinë e përcaktuar nga autoritetet komunale në distancë deri 10 km. Vërejtje: Sasia e shënuar paraqet vëllimin e ngjeshur ku nuk është marrë parasysh koeficienti i shkriftësisë.	m ³	213.00	4.00 € 852.00 €
1.02.02	Gërmimi i dheut i kategorisë III-IV, me ngarkim dhe bartje deri në deponi në largësi min 15km. Gërmimi i dheut të kategorisë III-IV, me makineri dhe dorë deri në 30 cm, për përgatitjen e terrenit tek pjesa ku do të punohet pllatoja, stazat për ecje dhe uleset. Në çmim duhet të përfshihet edhe transportimi i dheut të gërmuar deri në deponinë e përcaktuar nga autoritetet komunale në distancë deri 10 km. Vërejtje: Sasia e shënuar paraqet vëllimin e ngjeshur ku nuk është marrë parasysh koeficienti i shkriftësisë.	m ³	106.90	4.00 € 427.60 €
1.02.03	Planifikimi dhe nivellimi i nënbazës në pjesën e parkut ku do të punohet pllatoja, stazat për ecje dhe uleset, si dhe ngjeshja e saj me cilindër deri në masë të kërkuar sipas normave dhe standardeve për këtë lloj pune (Mts400 kg/cm ²)	m ²	462.10	0.50 € 231.05 €

1.

2.

3.

1.02.04	Furnizimi, transporti dhe shtrirja e shtresës së gjeotekstilëve në sipërfaqen e parkut në pjesët dhe sipas shtresave të parapara në projekt. Gjeosintetika duhet të jetë min. 300 g/m ² dhe duhet të përmbushë të gjitha kërkesat teknike sipas normave dhe standardeve në fuqi për këtë lloj materiali.	m ²	462.10	1.50 €	693.15 €
1.02.05	Furnizimi, transporti dhe shtrirja e gurit të thyer, fraksion {0-60} mm, për mbushje në terë hapsirë të parapara të punohet pllatoja dhe pjesës ku do të punohen kubezat me trashësi d=20 cm, duke e përfshirë edhe ngjeshjen me cilindër vibrues deri në masë densiteti të kërkuar sipas normave dhe standardeve në fuqi për këtë lloj pune (M _t ≥600 kg/cm ³).	m ³	71.30	11.00 €	784.30 €
1.02.06	Furnizimi, transporti dhe shtrirja e gurit të thyer, fraksion {0-31} mm, për mbushje, terë sipërfaqes të parapara të punohet pllatoja dhe pjesës ku do të punohen kubezat me shtresë me trashësi d=15 cm, duke e përfshirë edhe ngjeshjen me cilindër vibrues deri në masë densiteti të kërkuar sipas normave dhe standardeve në fuqi për këtë lloj pune (M _t ≥600 kg/cm ³). Ngjeshja duhet të bëhet në shtresë 10 cm.	m ³	76.30	12.00 €	915.60 €
1.02.07	Furnizimi, transporti dhe shtrirja e gureve dekorues në pjesën e parkut të parapara në projekt me trashësi 5cm. Guret dekorues duhet të jenë me ngjyrë të bardhë dhe duhet të vendosen gjatë kohës kur betoni është i njomë.	m ²	57.00	13.00 €	741.00 €
TOTAL POZICIONI 1.02					4,644.70 €

1.03 PUNËT E PLLATOSE ME KUBEZA					
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI/NJËSI	TOTAL
1.03.01	Furnizimi transporti dhe montimi i pllakave prej dy komponenteve me dimensione 60/30/8 cm; dhe të bazuara në ngjyrë hiri e hapur (ngjyrë betoni). Komponenta e parë prej betoni premium i ngjeshur, vibrues dhe i tharë në furrë me dy shtresa, pranimit (thithja) e ujit e reduktuar në 90%. Shtresa e sipërme nga gurëz të fisnikëruar graniti, madhësia maksimale e kokrës (gurit) 3 mm, me përpunim termostatik si dhe trajtim hidrofobik (kundër pranimit të ujit). Montimi duhet të bëhet sipas udhëzimeve të prodhuesit dhe fugat për distancim duhet të jenë 8mm me material të Basaltit fraks. 0/2 mm. Kriteret vëljuese të sipërfaqes së mveshur duhet të përmbushen dhe të dëshmohen përmes provave-me përmbajtjen ATEST në secilin plke: : 1) Rezistenca ndaj rrëshqitjes sipas DIN EN 1339 për pllaka betoni sipas DIN 51130 min. R11 ose standard të ngjashëm të EU. 2) Prova e fortësisë (qendrueshmërisë) së, ndaj lakimit (deformimit) dhe tërheqjes me aftësi ~6 MPa. 3) Rezistenca nga makinat për pastrim (fshesat me fije plastike /fshesat me tela) 4) Çvendosja (rrëshqitja) në sipërfaqet me frekuentim (qarkullim) të lartë, RSF5 5) Rezistenca ndaj rrëshqitjes SRT sipas DIN EN 1335 ose standard të ngjashëm EU. 6) Qëndrueshmëria ndaj substancave kimike për pastrim, RSF 5, etj. Vërejtje: Të gjitha pikat e shënuara me lartë të dëshmohen me ateste të veqanta të standardeve DIN ose të EU-së. Të gjitha punët duhet të kryhen në pajtim me projektantin dhe në udhëzim të organit mbikqyrës.	m ²	258.20	16.00 €	4,131.20 €

1.

2.

3.

1.03.02	Furnizimi transporti dhe montimi i pllakave prej dy komponenteve me dimensione 60/30/8 cm; dhe të bazuara në ngjyra e verdhe (pigmenti të vendoset gjatë procesit të prodhimit). Komponenta e parë prej betoni premium i ngjeshur, vibruar dhe i tharë në furrë me dy shtresa, pranimi (thithja) e ujit e reduktuar në 90%. Shtresa e sipërme nga gurëz të finisieruar graniti, madhësia maksimale e kokrrës (gurit) 3 mm, me përpunim termostatik si dhe trajtim hidrofobik (kundër pranimi të ujit). Montimi duhet të bëhet sipas udhëzimeve të prodhuesit dhe fugat për distancim duhet të jenë 8mm me material të Basaltit fraks. 0/2 mm. Kriteret vijuese të sipërfaqes së mveshur duhet të përmbushen dhe të deshmohen përmes provave-me përmbajtjen ATEST në secilin pike: : 1) Rezistenca ndaj rrëshqitjes sipas DIN EN 1339 për pllaka betoni sipas DIN 51130 min. R11 ose standard të ngjashëm të EU. 2) Prova e fortësisë (qendrueshmërisë) së, ndaj lakimit(deformimit) dhe tërheqjes me afte si -6 MPa. 3) Rezistenca nga makinat për pastrim (fshesat me fije plastike /fshesat me tela) 4) Çvendosja (rrëshqitja) në sipërfaqet me frekuentim (qarkullim) të lartë,RSF5 5) Rezistenca ndaj rrëshqitjes SRT sipas DIN EN 1335 ose standard të ngjashëm EU. 6) Qëndrueshmëria ndaj substancave kimike për pastrim,RSF 5,etj. Vërejtje: Te gjitha pikat e shënuara me lartë të deshmohen me ateste të veqanta të standardeve DIN ose të EU-se. Te gjitha punët duhet të kryhen në pajtim me projektantin dhe në udhëzim të organit mbikqyrës .	m ²	65.80	16.00 €	1,052.80 €
1.03.03	Furnizimi, bartja prej dhe vendosja e skajorëve 8/20/100 me pamje ngjyrë të hirit me kualitet acc. EN1340:2003, C37/45, M100 i vendosur në shtresë betoni C16/20 } duke përfshirë edhe testimet laboratorike për soliditet në shtypje, lakim abrazion dhe ngjirje shkrije.	m'	302.6	7.00	2,118.20
1.03.04	Furnizimi, bartja prej dhe vendosja e skajorëve 24/18/100 me pamje ngjyrë të hirit me kualitet acc. EN1340:2003, C37/45, M100 i vendosur në shtresë betoni C16/20 } duke përfshirë edhe testimet laboratorike për soliditet në shtypje, lakim abrazion dhe ngjirje shkrije.	m'	151.8	14.00	€ 2,125.20
1.03.05	Furnizimi dhe montimi i pllakave të betonit C37/45 me trashësi t=8.0cm me dimensione 90 x 200 cm (preferohen të kenë një rrjet Q166). Në vlera referuese të Standardeve Evropiane EN 13748-2 Pllaka për përdorim në hapësira të hapura në ambiente të jashtme. Montimi i pllakave bëhet në shtresën e rres fraksion 4-8mm me trashësi 10 cm, parashihe vendosja e gjeotekstilit 300 gr/m2 si edhe mbushja e fugave me rërë të imët, si dhe ngjeshja e tyre.	cope	12.0	30.00	€ 360.00
1.03.06	Furnizimi me material,kalëpimi dhe betonimi i shiritit me trashësi 8cm, C25/30 në formë të xhubletës sipas vizatimit të parapare tek pjesa grafike.	m ³	6.5	120.00	€ 780.00
	Vërejtje:Para betonimit të bëhet vendosja e gypit fleksibil për instalimin e dritave si dhe vendosja e gureve dekorative kur betoni është i njomë në mënyrë që të kapen me të (të parapara në pozicione tjera).				
	Në qmim të përfshihen të gjitha mjetet lidhëse, distancuesit dhe kalëpet e nevojshme për realizimin e këtij pozicioni.				
TOTAL POZICIONI 1.03					10,567.40 €

1.05	PUNËT E GJELBRIMIT	NJESIA	SASIA	ÇMIMI/NJESI	TOTAL
	PËRSHKRIMI I PUNËVE				
1.05.01	Furnizimi, transporti dhe shtrirja e dheut natyral-tekstura e dheut duhet të jetë lymore, lymore-argjillore ose ranore-argjillore, pra nuk duhet të jetë shumë e rëndë (argjillore) ose ranore. Nuk duhet të përmbajë gurë dhe mbetje tjera të padëshiruar. Pastaj duhet të jetë e pasur me materie ushqyese dhe të ketë pH optimale, përkatësisht mund të jetë e dobët acidike deri e dobët bazike.Mbushja duhet të bëhet për të nivelizuar terrenin brenda hapësirës së parkut me trashësi ~40cm. Për këtë duhet pasur kujdes vendi se ku merret dheu, ai duhet të merret në shtresën e sipërme të tokës përkatësisht në thellësi 20-25 cm, e kurrësi nuk duhet marr dhe në thellësi më të mëdha se 50 cm për shkak se kalon në substratin armë të tokës dhe nuk ka veti të mira fizike, kimike e biologjike. Te gjitha punët duhet të kryhen në pajtim me projektantin dhe në udhëzim të organit mbikqyrës.	m ³	465.60	6.00 €	2,793.60 €

1.

2.

3.

DRAFT - PARAMASA DHE PARALLOGARIA**HARTIMI I PROJEKTIT TË PARKUT "XHUBLETA"****LOKACIONI: GJAKOVË****INVESTITORI: KUVENDI KOMUNAL GJAKOVË****VËREJTJE:**

Materialet e propozuara në përshkrim teknik dhe paramasë janë opcionale dhe pikë referimi për karakteristikat e materialeve që duhet të përdoren andaj të gjitha ato mund të zëvendësohen me materiale të prodhuesve tjerë me karakteristika të njëjta ose më të mira që duhet dëshmuar me certifikatat apo atestet e ofrura nga prodhuesit respektiv. Në të gjitha pozicionet përfshihet FURNIZIMI DHE MONTIMI/PUNIMI I ATIJ POZICIONI. TEK PASTRIMET, DEMOUMET E GERMIMET TË PËRFSHIHET EDHE TRANSPORTI DERI NË DEPONI.

1 PUNËT NDËRTIMORE					
1.01 PUNËT PARAPREGADITORE DHE DEMOLIMEVE					
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJESIA	SASIA	ÇMIMI/NJESI	SHUMA
1.01.01	Mobilizimi i ndërmarrjës për fillimin e punimeve si në projekt. Sjellja e makinerive të nevojshme për fillim të punimeve.	cope	1	250.00 €	250.00 €
1.01.02	Furnizimi me material për vedosjen e tabelës me emrat e investitorit, ndërmarrjes projektuese dhe ndërmarrjes ndërtuese, vlerës investuese dhe fillimin dhe mbarimin e projektit. Tabela duhet të punohet nga materialet e kualitetit të lartë- shtypje me ngjyra në cerade dhe me shtyp të kualitetit të mirë për dukje të qartë nga distanca e largët. Dimensionet minimale të tabelës duhet të jenë: Gjatësia 2.5m, Gjerësia 1.5m, si dhe lartësia totale së bashku me këmbezat 2.5-3.0m. Të gjitha duhet të punohen me udhëzime nga mbikqyresit të punimeve.	cope	1	250.00 €	250.00 €
1.01.03	Të parashihet zyra e përkohshme e ndërmarrjës më së paku 2 ndarje, secila ndarje duhet të ketë së paku sipërfaqe S=12m2, me një sanitare si dhe e kyçur në furnizimin me energji të pandërprerë elektrike dhe të ujit. Zyra duhet të ketë lidhje në kanalizimin publik funksional ose në një rezervuar ekologjik mobil	cope	1	500.00 €	500.00 €
1.01.04	Të bëhet pastrimi i terrenit prej materialeve të cilat konsiderohen pengesa për zhvillimin e punimeve, si: heqja e shkurreve, pjesëve të betonit/ thyerja e tyre dhe mbeturinave/materialeve të tjera që ndodhen në sipërfaqe të terrenit të parkut. Njëherë materiali i grumbulluar parashihet të dërgohet/transportohet deri në depoin, sipas Menagjerit të kontratës, (largësia në rreze deri në 5km).	m²	1,420	1.00 €	1,420.00 €
1.01.05	Shënjestimi i instalimeve nëntoksore të cilat nuk çvendosen nga pozicioni ekzistues. Të bëhet edhe shënjestimi i lokacionit para fillimit të punimeve ku parashihet lokacioni për punimin e parkut xhubleta.	cope	1	300.00 €	300.00 €
1.01.06	Rrethimi i komplet punishtës në perimetër të saj në mënyrë që mos të ketë qasje nga kalimtarët e rastit. Rrethimi të bëhet nga materialet perkatese për këtë lloj pune d.m.th nga materialet perkatese dhe i cili lejon zhvillim normal të punimeve në gjithë orarin sipas kërkesave të investitorit.	m'	170	3.00 €	510.00 €
1.01.07	Pozicionimi gjeodezik i parcelës në të cilën do të punohet parku si dhe shënjestimi i elementeve të parkut.	komplet	1	300.00 €	300.00 €
TOTAL POZICIONI				1.01	3,530.00 €

1.02 PUNËT E GERMIMIT, DHEUT DHE TË ZHAVORIT					
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJESIA	SASIA	ÇMIMI/NJESI	SHUMA
1.02.01	Gërmimi i shtresës së humusit dhe dheut me trashësi deri 15 cm tërë sipërfaqen e paraparë për punimin e parkut. Në çmim duhet të përfshihet edhe transportimi i dheut të gërmuar deri në deponinë e përcaktuar nga autoritetet komunale në distancë deri 10 km. Vërejtje: Sasia e shënuar paraqet vëllimin e ngjeshur ku nuk është marrë parasysh koeficienti i shkriftësisë.	m³	213.00	4.00 €	852.00 €
1.02.02	Gërmimi i dheut i kategorisë III-IV, me ngarkim dhe bartje deri në depoini në largësi min 15km. Gërmimi i dheut të kategorisë III-IV, me makineri dhe dorë deri në 30 cm, për përgatitjen e terrenit tek pjesa ku do të punohet pllatoja, stazat për ecje dhe uleset. Në çmim duhet të përfshihet edhe transportimi i dheut të gërmuar deri në deponinë e përcaktuar nga autoritetet komunale në distancë deri 10 km. Vërejtje: Sasia e shënuar paraqet vëllimin e ngjeshur ku nuk është marrë parasysh koeficienti i shkriftësisë.	m³	106.90	4.00 €	427.60 €
1.02.03	Planifikimi dhe nivelizimi i nënbazës në pjesën e parkut ku do të punohet pllatoja, stazat për ecje dhe uleset, si dhe ngjeshja e saj me cilindër deri në masë të kërkuar sipas normave dhe standardeve për këtë lloj pune (Mts 400 kg/cm²)	m²	462.10	0.50 €	231.05 €

1.02.04	Furnizimi, transporti dhe shtrirja e shtresës së gjeotekstilit në sipërfaqen e parkut në pjesët dhe sipas shtresave të parapara në projekt. Gjeosintetika duhet të jetë min. 300 g/m ² dhe duhet të përmbushë të gjitha kërkesat teknike sipas normave dhe standardeve në fuqi për këtë lloj materiali.	m ²	462.10	1.50 €	693.15 €
1.02.05	Furnizimi, transporti dhe shtrirja e gurit të thyer, fraksion (0-60) mm, për mbushje në terë hapsirë të parapara të punohet pllatoja dhe pjesës ku do të punohen kubezat me trashësi d=20 cm, duke e përfshirë edhe ngjeshjen me cilindër vibrues deri në masë densiteti të kërkuar sipas normave dhe standardeve në fuqi për këtë lloj pune (Mt≥600 kg/cm ³).	m ³	71.30	11.00 €	784.30 €
